

## RREGULLORE

### PËR FUNKSIONIMIN E KOMITETIT RAJONAL TË PARANDALIMIT TË RADIKALIZMIT DHE LUFTËS KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM, NË QARKUN FIER

Në zbatim të shkronjës f të pikës 4 dhe shkronjës dhe pikës 11 të Urdhrit nr. 185 datë 31.10.2023 të Kryeministrit, "Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm", Komiteti Rajonal i Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Qarku Fier referuar në vazhdim si Komiteti, miraton rregulloren për funksionimin e Komitetit Rajonal të Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm si edhe të Sekretariatit të tij teknik:

#### KREUI DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1 Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar rregullat e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Komitetit Rajonal për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (*Komiteti*) si edhe të Sekretariatit të tij Teknik (*Sekretariati*), duke përfshirë edhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të marrëdhënieve të ndërsjella me institucionet shtetërore dhe jo shtetërore, përgjegjëse për parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceseve të rehabilitimit, ri- integritit dhe risocializimit të të kthyerve nga zonat e luftës Siri dhe Irak, në nivel qarku.

##### Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është:

1. Krijimi i kornizës së nevojshme rregulluese për të realizuar një funksionim sa më efektiv dhe të koordinuar të Komitetit, anëtarëve të tij, Sekretariatit Teknik si edhe marrëdhënien e tyre me aktorë të tjerë që mund të thirren si pjesëmarrës në mbledhjet e Komitetit, sipas çështjeve të caktuara.
2. Ndërtimi i një kornize rregulluese, e cila u krijon strukturave të Komitetit (përfshirë edhe Sekretariatit) mundësinë dhe hapësirat e nevojshme që në punën e tyre, të respektojnë parimet e ligjshmërisë, unitetit dhe hierarkisë, profesionalizmit, llogaridhënies, efektivitetit, transparencës, gjithë përfshirjes, qëndrueshmërisë etj.

##### Neni 3 Fusha e Zbatimit

1. Kjo Rregullore i shtrin efektet e saj mbi të gjithë anëtarët e Komitetit si edhe Sekretariatit Teknik.
2. Për aktorë të tjerë të përfshirë në mbledhjet e Komitetit, për çështje të caktuara, mënyra e bashkëpunimit dhe komunikimit do të funksionojë sipas kësaj Rregulloreje dhe akteve të tjera ligjore, nënligjore në



fuqi.

#### Neni 4

#### Parimet e organizimit dhe funksionimit

1. Komiteti dhe të gjithë anëtarët e tij udhëhiqen nga parimi i ndërtimit të marrëdhënieve pozitive, të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis tyre, si dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceseve të Rehabilitimit, Ri-integrimit dhe Risocializimit.
2. Komiteti punon në bashkëpunim me shoqërinë civile, duke vlerësuar maksimalisht kontributin dhe angazhimin e tyre në parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceseve të Rehabilitimit, Ri-integrimit dhe Risocializimit.
3. Komiteti kur e gjykon të nevojshme i fton Organizatat jofitimprurëse (OJF), Organizatat joqeveritare (OJQ), në mbledhjet e tij dhe krijon të gjitha lehtësitat e duhura që ato me vullnetin e tyre të bëhen pjesë aktive e tryezave teknike.

#### KREU II

#### STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOMITETIT

#### Neni 5

#### Krijimi i Komitetit

1. Komiteti është krijuar me Urdhrin nr. 185 datë 31.10.2023 të Kryeministrit "*Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm* ", në çdo qark.
2. Komiteti është ngritur me qëllim të identifikimit dhe referimit të rasteve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm (individët apo grupet vulnerabil në rrezik radikalizmi apo të radikalizuar), ndjekjes së të gjitha veprimeve, masave dhe aktorëve (shtetërorë ose jo shtetërorë) të përfshirë në parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceset e rehabilitimit, ri integrimit dhe risocializimit të personave të kthyer nga zonat e luftës, në nivel qarku, pranë Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm. Gjithashtu, Komiteti shërben si urë lidhëse për trajtimin e nevojave sociale dhe ekonomike më të gjera të rasteve të identifikuara në rrezik radikalizmi apo të radikalizuara në qark.

#### Neni 6

#### Përbërja e Komitetit

1. Komiteti drejtohet nga Prefekti i Qarkut dhe në përbërje të tij janë të gjitha institucionet dhe agjencitë shtetërore përgjegjëse dhe ose të përfshira në parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceseve të Rehabilitimit, Ri-integrimit dhe Risocializimit në, nivel vendor/qarku.
2. Të gjithë anëtarët e Komitetit janë të barabartë midis tyre dhe gjatë gjithë angazhimit dhe veprimtarisë në Komitet duhet të udhëhiqen nga parimet e solidaritetit, humanizmit dhe përgjegjësisë individuale.





3. Komiteti për çështje të caktuara, mund t'i propozojë Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, thirrjen e një eksperti të jashtëm.
4. Anëtarët e Komitetit duhet të paraqiten në Komitet të informuar dhe të përgatitur për të raportuar në emër të strukturave respektive, për çështjet e Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në përputhje me Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit dhe planeve përkatëse të veprimit.
5. Në rastet kur vlerësohet e nevojshme dhe sipas çështjeve që do trajtohen, në takimet e Komitetit, mund të ftohen të marrin pjesë Kryetari i Këshillit të Qarkut, Kryetari/kryetarët i/e bashkisë/bashkive, drejtuesit e prokurorive të rretheve gjyqësore, anëtarë të bashkësive fetare, përfaqësues nga shoqëria civile dhe organizata apo agjenci të tjera. Marrëdhënia me këto institucione do bazohet në parimin e konsultimit dhe bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Neni 7  
Sekretariati teknik

1. Me qëllim sigurimin e mbështetjes administrative, koordinuese, logjistike dhe të të gjithë veprimtarisë të Komitetit, pranë Prefekturës krijohet Sekretariati Teknik i Komitetit, personel i cili caktohet nga vetë Prefekti (në cilësinë e Kryetarit të Komitetit) dhe është pjesë e administratës.
2. Për mirëfunksionimin e Sekretariatit Teknik, Kryetari i Komitetit, cakton një anëtar të Sekretariatit Teknik **në rol koordinues dhe si pikë kontakti midis Sekretariatit dhe Komitetit** apo aktorëve të tjerë të përfshirë.
3. Pjesë e sekretariatit teknik të Komitetit ndër të tjerë, do të jenë edhe punonjës me funksione dhe njohuri të thelluara, në fushën e Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, proceset e Rehabilitimit, Ri-integrimit dhe Risocializimit të cilët përzgjidhen nga kryetari i Komitetit.

### KREU III DETYRAT DHE PËRGJEGJESITË E KOMITETIT DHE SEKRETARIATIT TEKNIK

Neni 8  
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit

Komiteti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij në të gjithë territorin e qarkut në zbatim të Urdhrit nr.185 datë 31.10.2023 të Kryeministrit, Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit dhe planeve përkatëse të veprimit si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Koordinon dhe ndjek të gjitha veprimet, masat dhe aktorët e përfshirë në parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceseve të Rehabilitimit, Ri-integrimit dhe Risocializimit të të kthyerve nga zonat e luftës në nivel vendor/qarku.



2. Kryen vlerësime periodike për fenomenin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në nivel qarku dhe bën përcaktimin e prioriteteve për veprim në nivel qarku, në përputhje dhe në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit dhe planeve përkatëse të veprimit
3. Në bazë të studimeve dhe të vlerësimeve bën përcaktimin e nevojave specifike të qarkut si dhe të tendencave të fenomenit në nivel qarku.
4. Bën identifikimin e personave në rrezik radikalizmi, të radikalizuar në nivel qarku, si dhe merr masat për referimin dhe trajtimin e tyre duke shfrytëzuar kapacitetet dhe mundësitë që ofron qarku.
5. Bën identifikimin e individëve dhe të grupeve të rrezikuara nga radikalizmi, si dhe merr masa për ngritjen e rrjeteve të aktorëve me qëllim parandalimin e radikalizmit.
6. Sigurohet për ndjekjen e planit të masave të marra nga institucioni përgjegjës koordinues, mbi nevojat e individëve të kthyer nga zonat e konfliktit si dhe merr masa për ngritjen dhe bashkëpunimin e rrjeteve të aktorëve aktiv në proceset e rehabilitimit, ri-integrimit dhe risocializimit të tyre.
7. Ndërmerr masa konkrete për parandalimin e radikalizmit dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, nëpërmjet, tryezave të rrumbullakëta, takimeve informuese dhe fushatave të ndërgjegjësimit, krijimit të mekanizmave të mbrojtjes dhe të referimit të rasteve, duke krijuar një tabelë të plotë të dhënash për secilën problematikë.
8. Shërben si bërthamë për trajtimin e nevojave sociale dhe ekonomike më të gjera të rasteve të identifikuar në qark, në rrezik radikalizmi apo të radikalizuara, që lidhin ndërveprimin në këtë fushë me arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, fëmijët në nevojë, çështje të respektimit të rendit publik etj.
9. Shërben si urë lidhëse përgjegjëse koordinuese ndërmjet Zyrës së Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për koordinimin e veprimtarisë për parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceseve të rehabilitimit, ri-integrimit dhe risocializimit të të kthyerve nga zonat e luftës Siri dhe Irak, në nivel qarku.
10. Zbaton me përgjegjësi të gjitha detyrat dhe udhëzimet e lëna nga Kryetari i Komitetit Rajonal i Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, si dhe nga Koordinatori Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.
11. Është partner vendor dhe pikë kontakti edhe për autoritetin përgjegjës për zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit të rasteve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
12. Raporton periodikisht çdo tre muaj, gjashtë muaj dhe raport vjetor, nëpërmjet Kryetarit të Komitetit tek Koordinatori Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, për të gjithë veprimtarinë e tij.
13. Propozon strategji konkrete për adresimin e çështjeve dhe problematikave që kanë të bëjnë me parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm si dhe rehabilitimin e të riatdhesuarave nga zonat e konfliktit.

#### Neni 9

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e sekretariatit teknik

Sekretariati teknik ka këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Koordinon dhe organizon takimet e Komiteti Rajonal të Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës




- kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, në çdo qark;
2. Siguron grumbullimin dhe shkëmbimin e materialeve për takimet e planifikuara dhe njofton anëtarët për takimet e Komiteti Rajonal të Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.;
  3. Bashkërendon punën ndërmjet institucioneve të përfshira për zbatimin dhe monitorimin e detyrave të lëna nga Komiteti.
  4. Mban procesverbale e mbledhjeve dhe harton vendimet e marra nga Komiteti.
  5. Siguron mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave në nivel qarku për detyrat e parandalimit të radikalizmit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm, si dhe administron ato për raste konkrete të trajtuara në tryezat ndërinstitucionale teknike rajonale që mund të ngrihen për këtë qëllim apo në Komitet;
  6. Harton raportet mujore të zbatimit të planit të punës të këtij komiteti.
  7. I siguron mbështetjen administrative dhe logjistike për veprimtarinë e komitetit, i ndihmuar nga struktura përkatëse e shërbimeve pranë çdo qarku.
  8. Kryen dhe detyra të tjera të përcaktuara nga Kryetari i Komitetit.
  9. Kujdeset për zbatimin e detyrimeve që i ngarkohen nga Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit dhe planeve përkatëse të veprimit, si dhe planit të punës së miratuar nga Komiteti.
  10. Mban, ruan dhe përditëson të gjitha kontaktet e anëtarëve të Komitetit dhe tryezave ndërinstitucionale teknike që mund të mblidhen për këtë qëllim.
  11. Ruan dhe administron me përgjegjësi të gjitha dosjet dhe të dhënat e përpunuara nga Komiteti, përfshirë edhe dosjet me të dhëna për raste të veçanta.
  12. Kujdeset për shkëmbimin e informacionit, midis anëtarëve të Komitetit duke respektuar parimin e ruajtjes së konfidencialitetit dhe të sigurisë së të dhënave, sidomos të atyre të kthyer nga zonat e konfliktit dhe me raste konkrete që janë proces hetimi apo gjykimi.
  13. Sekretariati teknik i Komitetit është përgjegjës për komunikimin e të dhënave dhe referimin e rasteve konkrete tek autoriteti përgjegjës, nëpërmjet Kryetarit.
  14. Është përgjegjës për përgatitjen e raporteve periodike dhe informacioneve të ndryshme, çdo tre muaj, gjashtë muaj dhe raport vjetor, të cilat në emër të Komitetit duhet të dërgohen pranë Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, nëpërmjet Kryetarit.

KREU IV  
ORGANIZIMII MBLEDHJEVE TË KOMITETIT

Neni 10  
Mbledhjet e Komitetit

1. Në zbatim të Urdhrit nr.185 datë 31.10.2023 të Kryeministrit, udhëzimeve dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, Komiteti zhvillon mbledhje periodike, **të paktën 1 (një) herë në tre muaj**, por edhe me shpesh në varësi të nevojave dhe problematikave të hasura.





2. Mbledhjet e Komitetit thirren dhe drejtohen nga Kryetari i Komitetit dhe nga Koordinatori Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm
3. **Të paktën 5 ditë para çdo mbledhje, anëtarët e Komitetit dorëzojnë pranë Sekretariatit teknik, raportimin e përgatitur sipas fushave të tyre të përgjegjësisë.**
4. Sekretariati kujdeset për anën administrative dhe logjistike të zhvillimit të mbledhjeve, i cili merr të gjitha masat për njoftimin në kohë të anëtarëve dhe të personave të tjerë që duhet dhe mund të fitohen në mbledhje.
5. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjeve dërgohet, të paktën, **5 ditë pune përpara datës së mbledhjes**, me shpresë ose/edhe në formë elektronike (faks apo e-mail), për të cilën anëtarët e Komitetit kanë rënë dakord paraprakisht. Bashkë me njoftimin dërgohet edhe rendi i ditës si dhe një përmbledhje e çështjeve që do të trajtohen në mbledhje. Njoftimi për mbledhjen e radhës pasohet nga konfirmimi i pjesëmarrjes nga ana e anëtarit të ftuar, i cili merr masat përkatëse për të qenë prezent në mbledhje.
6. Përpara zhvillimit të çdo mbledhjeje, Sekretariati përgatit një informacion paraprak për problematikat që do të trajtohen, si dhe sjell në vëmendje të Komitetit çështje specifike, për të cilat është rënë dakord paraprakisht në mbledhjet paraprake të tryezës.
7. Për mbledhjen e radhës njoftohet, paraprakisht, Koordinatori Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm. Së bashku me njoftimin përcillen agjenda si dhe informacione të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin e mbledhjes.
8. Pas përfundimit të mbledhjes, Sekretariati përgatit një raport të hollësishëm i cili i dërgohet nëpërmjet Kryetarit të Komitetit, Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm si dhe për dijeni të gjithë anëtarëve të Komitetit.

#### Neni 11

#### Procedura e zhvillimit të mbledhjes

1. Mbledhja hapet dhe moderohet nga Kryetari i Komitetit, i cili bën edhe prezantimin e rendit të ditës si dhe një përmbledhje të zhvillimeve të fundit të punës së Komitetit.
2. Në bazë të rendit të ditës, fjalën e marrin me radhë të gjithë anëtarët e Komitetit, të cilët krahas komenteve për çështjet e përcaktuara në rend ditë, informojnë Komitetin edhe për veprimtarinë e strukturës që ai përfaqëson për periudhën midis dy mbledhjeve.
3. Gjatë zhvillimit të mbledhjes **mbahet procesverbal nga Sekretariati.**
4. Në procesverbal mbahet shënim edhe listë prezenca e pjesëmarrësve në mbledhje.
5. Përpara se të zbardhet, procesverbali i mbledhjes shkëmbehet për komente dhe nënshkrim, me të gjithë anëtarët e Komitetit dhe në fund shërben si bazë për të përgatitur raportimin përkatës për periudhën mujore midis mbledhjeve të Komitetit.
6. Vendimet në Komitet merren nga të gjithë anëtarët me shumicë të thjeshtë votash.
7. Në fund të mbledhjes, përveç zbatimit të planit të punës, nga Kryetari lihen detyra specifike për t'u ndjekur nga Komiteti dhe anëtarët e tij.

Handwritten signatures and initials in blue ink, including a date "E Hete 2014" and various initials like "H", "A", "B", "C", "D", "E", "F", "G", "H", "I", "J", "K", "L", "M", "N", "O", "P", "Q", "R", "S", "T", "U", "V", "W", "X", "Y", "Z".

KREU V  
MONITORIMI VEPRIMTARISE SE KOMITETIT

Neni 12  
Mbikëqyrja e veprimtarisë së Komitetit

1. Prefekti i Qarkut në cilësinë e Kryetarit të Komitetit, drejton, mbikëqyr, kontrollon dhe koordinon të gjithë veprimtarinë e Komitetit dhe strukturave përbërëse të tij. Ai kujdeset për ndarjen e përgjegjësive dhe zbatimin e të gjitha detyrave në nivel qarku, në kuadër të Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, proceseve të Rehabilitimit, Ri-integritit dhe Risocializimit të të kthyerve nga zonat e konfliktit.
2. Për të gjithë veprimtarinë e tij Kryetari i Komitetit, raporton dhe informon në vazhdimësi Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.
3. Me qëllim sigurimin e një angazhimi institucional, të qëndrueshëm dhe efikas të të gjitha strukturave të varësisë që janë pjesë e Komitetit, Prefekti në cilësinë e Kryetarit të Komitetit, vendos lidhje të drejtpërdrejta me titullarët e institucioneve në nivel lokal. Në rast të konstatimit të mangësive në ndjekjen dhe zbatimin e detyrave të strukturave shtetërore që janë pjesë e Komitetit, Prefekti informon Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm si dhe titullarin e institucioneve eprore të atyre të përmendura më sipër me qëllim marrjen e masave të nevojshme për rregullimin e këtyre mangësive.

KREU VI  
DISPOZITA TË TJERA

Neni 13  
Administrimi i të dhënave dhe shkëmbimi i informacionit

Të gjithë anëtarët e Komitetit dhe Sekretariatit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, tregojnë kujdes të veçantë në administrimin e të dhënave duke respektuar parimin e konfidencialitetit, si dhe duke bashkëpunuar për një shkëmbim të sigurt të dhënash, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 14  
Hartimi i planit të punës

Komiteti harton dhe miraton planin e punës, për një periudhë 1-vjecare:

1. Plani i punës duhet të ketë të përcaktuara nevojat e qarkut dhe të jetë i bazuar në këto nevoja.
2. Plani i punës të jetë në përputhje të plotë me Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit dhe planeve përkatëse të veprimit.
3. Për të përfshirë masat e duhura në planin e punës, Komiteti do të bazohet në masat e parashikuara në planet përkatëse të veprimit.
4. Në planin e punës duhet të përcaktohen qartë detyrat dhe aktivitetet, institucionet përgjegjëse si dhe



afatet për realizimin e tyre.

5. Plani i punës duhet të konsultohet, paraprakisht, me Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.
6. Plani i punës, duhet të miratohet nga Komiteti në mbledhjen e tij të parë, e cila si rregull duhet të zhvillohet brenda muajit Janar të vitit, për të cilin hartohet ky plan pune.

#### Neni 15

#### Mbajtja e kontakteve

1. Të gjitha strukturat e përfshira në Komitet, në bashkëpunim edhe me agjencitë e tjera shtetërore dhe jo shtetërore që janë apo jo, pjesë e Komitetit dhe strukturave organizative të tij, apo struktura të përfshira në çështje të caktuara, janë të detyruar, në bazë të kësaj Rregulloreje, të vënë në dispozicion listën e kontakteve të krijuara si rezultat i veprimtarisë së tyre, me informacion mbi emër/mbiemër, numër telefon/celular, adresë, e-mail, arsyen e kontaktimit, rolin e këtyre kontakteve, me qëllim për të krijuar një databazë të përmbledhur të dhënash.
2. Kjo listë të dhënash, dërgohet pranë Kryetarit, i cili, nëpërmjet Sekretariatit, krijon një listë të përmbledhur. Këto të dhëna, në çdo moment, mund t'i bëhen me dije Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.
3. Të dhënat e mbledhura do të përdoren vetëm për qëllim të funksionit të Komitetit dhe në përputhje të plotë me aktet ligjore/nënligjore në fuqi, për mbrojtjen e të dhënave.

#### Neni 16

#### Formati i Raportimit të Komiteti Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

Për përgatitjen e raportit të Komitetit Rajonal të Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm , në çdo qark, çdo anëtar, duhet të këtë në vëmendje:

1. Raporti i përgatitur nga Komiteti duhet të jetë produkt i punës se të gjithë anëtarëve të Komitetit.
2. Raportimi duhet të jetë periodik (**çdo tre muaj, gjashtë muaj dhe vjetor**) dhe përmbajtja e raportit duhet të japë informacion vetëm për periudhën për të cilën raportohet dhe të evidentojë qartë përditësimet nga raporti i fundit.
3. Raporti duhet të përmbajë informacion për zbatimin e planit të punës të Komitetit si dhe mbi konstatimet në fushën e veprimit të secilit prej anëtarëve.
4. Raporti duhet të përmbajë informacion të përpunuar dhe të organizuar mirë, si nga pikëpamja e strukturës ashtu edhe e përmbajtjes.
5. Gjuha e përdorur duhet të jetë e qartë, e thjeshtë dhe e kuptueshme.
6. Duhet shmangur në maksimum përsëritjet dhe përkrahjet e tepërta që nuk japin informacion.
7. Raporti i secilit anëtar, duhet të hartohet dhe të përcillet te Kryetari i Komitetit, në formën e një shkrese zyrtare si edhe në mënyrë elektronike, me datë dhe me numër protokollit të institucionit që e dërgon. Sekretariati teknik mbledh raportet e secilit anëtar dhe përgatit raportin përfundimtar, i cili do të dërgohet në mënyrë elektronike në secilin anëtar për komente shtesë.



8. Secili anëtar, përgjigjet mbi komentet shtesë, brenda pesë ditë pune, dhe në rast të mungesës së komenteve shtesë, ky fakt, do të konfirmohet po në mënyrë elektronike. Pas mbarimit të kësaj faqe, raporti përfundimtar do të zbardhet nga Sekretariati dhe do të nënshkruhet nga Kryetari dhe të gjithë anëtarët e tij, në çdo faqe.
9. Në përfundim të nënshkrimit të plotë, raporti përfundimtar duhet të përcillet pranë Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, në rrugë zyrtare dhe në format elektronik në adresat përkatëse, nëpërmjet Kryetarit. Ky raport i dërgohet, për dijeni, të gjithë anëtarëve të Komitetit.
10. Struktura e raportit përfundimtar, ndër të tjera, duhet të përmbajë një përmbledhje e veprimtarisë së Komitetit për periudhën që raportohet, konkretisht si më poshtë:
  - i. Ecurinë e realizimit të detyrave të lëna nga mbledhjet e mëparshme nga Kryetari i Komitetit dhe Koordinatori Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe arsyet e mosrealizimit të tyre.
  - ii. Të citohen të gjitha aktivitetet e organizuara nga Komiteti dhe anëtarët e saj, sipas fushës së veprimit të secilit dhe një përshkrim i shkurtër mbi ecurinë dhe rezultatin e aktivitetit.
  - iii. Të citohen masat, veprimet dhe aktorët e përfshirë për parandalimin e radikalizmit, luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe proceseve të Rehabilitimit, Ri-integrimit dhe Risocializimit të të kthyerve nga zonat e luftës në nivel vendor/qarku.
  - iv. Vlerësimet përkatëse të secilit anëtar mbi fenomenin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në nivel qarku dhe përcaktimin e prioriteteve për veprim si edhe përditësim mbi nevojat specifike dhe tendencave të fenomenit në nivel qarku.
  - v. Informacione të tjera, në fushën e veprimit të secilit anëtar, konstatime dhe problematika të hasura si dhe propozime për adresimin e tyre.
  - vi. Informacion mbi trajtimin e nevojave sociale dhe ekonomike më të gjera të rasteve të identifikuara në qark, në rrezik radikalizmi apo të radikalizuara, që lidhin ndërveprimin në këtë fushë me arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, fëmijët në nevojë, çështje të respektimit të rendit publik etj.
  - vii. Të dhëna statistikore dhe tregues të arritjeve dhe rezultateve për periudhën që raportohet, duke evidentuar edhe krahasimin me periudhën e mëparshme.
  - viii. Komiteti, nëpërmjet Kryetarit, për rastet dhe çështjet ku është vlerësuar e nevojshme, pjesëmarrja në mbledhje edhe e Kryetarit të Këshillit të Qarkut, Kryetarit/kryetareve i/e bashkisë/bashkive, drejtuesit e prokurorive të rretheve gjyqësore, anëtarë të bashkësive fetare, përfaqësues nga shoqëria civile dhe organizata apo agjenci të tjera, ju kërkon informacion përditësues, në bazë të parimit të konsultimit dhe bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, dhe e përfshin këtë informacion në raportin përfundimtar për Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.
  - ix. Të dhënat duhet të përfshijnë informacion të përpunuar nga të gjitha strukturat/anëtarët që janë pjesë e Komitetit apo që janë përfshirë nga ky i fundit si aktorë pjesëmarrës, sipas nevojave të rasteve të ndryshme, ndër të tjera, për:
    1. Personat e identifikuar në rrezik radikalizmi dhe masat e marra për ngritjen e rrjeteve të aktorëve me qëllim parandalimin e radikalizmit, ecuria dhe rezultati i tyre, në realizim të planeve përkatëse të masave.
    2. Individët e kthyer nga zonat e konfliktit dhe masat e marra për ngritjen rrjeteve të aktorëve aktiv në proceset e rehabilitimit, ri-integrimit dhe risocializimit të tyre.
    3. Rastet e evidentuara nga Policia e Shtetit dhe të gjithë aktorët e tjerë, masat e marra në vijim



- dhe ecuria e tyre;
4. Personat e identifikuar si me rrezik radikalizmi, masat e marra në vijim dhe ecuria e tyre;
  5. Grupet dhe individët e rrezikuar nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, masat e marra në vijim dhe ecuria e tyre;
  6. Niveli i papunësisë për të gjitha kategoritë (gra, vajza, burra, studentë që janë diplomuar së fundmi apo dhe më parë), masat e marra lidhur me këtë çështje;
  7. Kapacitetet e shtuara për ofrimin e shërbimeve, (ecurinë dhe impaktin e tyre) nëse ka etj.
  8. Ndihmën dhe asistencën e dhënë për periudhën që raportohet;
  9. Planifikimi dhe programet për të ardhmen.
  10. Probleme, konstatime, pengesa dhe vështirësi të evidentuara gjatë punës së Komitetit si dhe propozime për adresimin e tyre.
  11. Sugjerime të tjera dhe rekomandime.

## KREU VII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

### Neni 17

#### Raportimi i parë për zbatimin e rregullores

1. **Brenda dhjetë ditë pune** nga miratimi i kësaj rregulloreje, Kryetari i Komitetit përcakton anëtarët e Sekretariatit Teknik dhe brenda **1 muaji kalendarik**, ky i fundit, përgatit një raport të hollësishëm për masat e marra në zbatim të asaj çfarë është përcaktuar në Urdhërin nr. 185 datë 31.10.2023 të Kryeministrit dhe këtë rregullore. Ky raport i paraqitet Kryetarit të Komitetit (Prefektit të Qarkut), si dhe i dërgohet për dijeni edhe Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.
2. Kryetari nga ana e tij, pasi njihet me këtë raport, merr masa për rregullimin e mangësive dhe është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kësaj rregulloreje.















### Neni 18

#### Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi më datë **31/01/2024**
2. Miratuar nga Komiteti Rajonal i Parandalimit të Radikalizmit dhe Luftës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Qarku Fier në mbledhjen e datës **31/01/2024 dhe do të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komitetit në çdo faqe.**
3. Pas përcaktimit të anëtarëve të Sekretariatit Teknik, kjo Rregullore do t'i bëhet me dije gjithashtu dhe do të nënshkruhet nga secili prej tyre në çdo faqe.

A collection of approximately ten handwritten signatures in blue ink, arranged in two rows. The signatures are stylized and vary in length and complexity, representing the members of the committee mentioned in the text above.



NR.	EMËR MBIEMËR	INSTITUCIONI	FIRMA
1	Lorenc Janpaukaj	D/Polreisor Fier	
2	Ervin Blushi	Drejtor I.E.V.P	
3	Ervin Haha	Drejtor NJVKSH Fier	
4	Alexandru Jolej	Jr. O.F.P.P. Fier	
5	Edlira Doko	DR AKPA Fier	
6	Armand Naji	Dr. SBSSH Fier	
7	Gentian Kicaj	Policia Ushtrake	
8	Ejon Furumaj	Policia Ushtrake	
9	Eduart Buzi	D.T. Shërbimit të Proves	
10	Marilla Jano	I.S.K.P.-SH-SH. Sektori Inspektimit Fier	
11	Ilir Jmeri	SVIKM Vlone	
12	Denis Korreshi	Drejtor NJVKSH LUSHNJE	
13	Eaton Isufaj	Drejtor NJVKSH Mallkatesi	
14	Raymonda Baelilaj	Prefekti i Qeveris Fier	
15			
16			